

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Vendim Nr. 460, datë 29.6.2022 “Për Miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021/2027”; 2. Vendim nr. 366, datë 16.6.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023–2027”; 3. Programi Qeverisë 2025-2029
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	4/6/2026 – 2/7/2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	26/08/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT?	Po
NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	19/08/2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026– MBZHR – Nr. VN 3
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Adra Gjongecaj e-mail-i: Adra.gjongecaj@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0692325402 Valdete Buca e-mail-i: Valdete.buca@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0693937433
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i> Politika e propozuar synon të adresojë mungesën e një kuadri ligjor dhe institucional të konsoliduar për rregullimin dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të profesionit të agronomit në Republikën e Shqipërisë. Aktualisht, ushtrimi i këtij profesioni nuk mbështetet në një strukturë të posaçme publike apo profesionale që të garantojë kritere të qarta për kualifikimin, rregulla për sjelljen profesionale dhe mekanizma përgjegjësie dhe disipline.	

Kjo situatë ka sjellë që profesioni i agronomit të ushtrohet në mënyrë të pakoordinuar me institucionet publike përgjegjëse për politikën bujqësore dhe mjedisore, si dhe me strukturat këshilluese dhe kontrolluese të sektorit, duke rezultuar në ofrim të shërbimeve teknike pa rregulla të qarta cilësie dhe pa mekanizma efektivë kontrolli dhe përgjegjësie, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në:

- cilësinë e shërbimeve këshilluese që u ofrohen fermerëve dhe operatorëve të sektorit,
- zbatimin e qëndrueshëm dhe të njëtrajtshëm të politikave bujqësore dhe mjedisore,
- besimin e publikut dhe institucioneve ndaj profesionit të agronomit.

Shkaqet kryesore të identifikuara të këtij problemi janë:

- mungesa e një kuadri ligjor që rregullon ushtrimin e profesionit të agronomit si profesion me funksion publik dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë ushqimore, mjedisin dhe zhvillimin territorial;
- mungesa e një enti publik profesional që të ofrojë vetërregullim, mbikëqyrje, kontroll disiplinor dhe promovim të formimit profesional të vazhdueshëm;
- mungesa e mbrojtjes ligjore të titullit profesional “Agronom”, çka krijon konfuzion profesional dhe cenon standardet e ushtrimit të profesionit.

Si pasojë, profesioni i agronomit nuk shfrytëzohet plotësisht në funksion të politikave publike bujqësore, ndërkohë që në të njëjtën kohë ushtrimi i tij zhvillohet në mungesë të mekanizmave të qartë të kontrollit dhe mbikëqyrjes, pavarësisht rëndësisë së drejtpërdrejtë që ka për rritjen e produktivitetit bujqësor, sigurinë ushqimore, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme, pasi profesioni i agronomit ushtron funksion publik dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në interesa themelore publike, përfshirë:

- sigurinë dhe cilësinë e prodhimit ushqimor,
- përdorimin e qëndrueshëm të tokës dhe burimeve natyrore,
- mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimin territorial,
- zbatimin e politikave kombëtare dhe angazhimeve ndaj Bashkimit Europian.

Në mungesë të ndërhyrjes shtetërore, tregu i shërbimeve profesionale agronomike nuk arrin të vetërregullohet në mënyrë efektive, duke krijuar rreziqe për cilësinë, përgjegjshmërinë dhe besueshmërinë e shërbimeve teknike. Për këtë arsye, ndërhyrja e qeverisë synon krijimin e Urdhrit të Agronomëve si ent publik profesional, i cili do të vendosë mekanizma të qartë për:

- rregullimin e aksesit në profesion mbi bazën e kualifikimit dhe aftësisë profesionale,
- mbikëqyrjen e ushtrimit të profesionit,
- zbatimin e standardeve etike dhe sistemeve disiplinore,
- promovimin e formimit dhe ricertifikimit profesional.

Propozimi për këtë politikë të re është në përputhje me praktikën më të mira evropiane për profesionet e rregulluara dhe synon jo kufizimin, por forcimin institucional dhe shoqëror të profesionit të agronomit, në funksion të interesit publik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit bujqësor.

Grupet e ndikuar në mënyrë direkte si dhe në mënyrë indirekte janë:

- Agronomët
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Fermerët
- Operatorët ekonomike në sektorin bujqësor
- Institucionet publike të lidhura me bujqësinë, mjedisin dhe sigurinë ushqimore

○ Konsumatorët

Nëpërmjet kësaj nisme synohet rregullimi dhe orientimi i ushtrimit të profesionit të agronomit përmes vendosjes së një kuadri të qartë ligjor dhe institucional, i cili forcon përgjegjësinë profesionale, rrit rolin shoqëror të agronomit dhe siguron ushtrimin e profesionit në funksion të interesit publik. Krijimi i Urdhrit të Agronomëve synon të sigurojë kontroll, mbikëqyrje dhe vetërregullim profesional, duke mundësuar shfrytëzimin e plotë të potencialit të agronomëve në zbatimin e politikave bujqësore, rritjen e produktivitetit, garantimin e sigurisë ushqimore, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore të politikës së këtij projektligji janë siç vijon:

1. Krijimi i bazës ligjore që kushtëzon ushtrimin e profesionit me anëtarësimin/regjistrimin në Urdhrin e Agronomit dhe respektimin e kriterëve të përcaktuara ligjore.
2. Garantimi i standardeve të detyrueshme teknike dhe etike, si dhe i mekanizmave efektivë të mbikëqyrjes dhe disiplinës profesionale, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në sektorin bujqësor.
3. Monitorimi i ushtrimit të profesionit dhe siguri i cilësisë që kontribuon në përmirësimin e sigurinë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Ngritja dhe funksionalizimi i Urdhrit të Agronomit si ent vetërregullues, që administron regjistrin profesional, zhvillimin profesional dhe bashkëpunimin institucional në sektor.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së (mosndërrhyrja)

Ruajtja e kuadrit aktual ligjor, pa përfshirë profesionin e agronomit në listën e profesioneve të rregulluara, nënkupton vijimin e ushtrimit të këtij profesioni në mungesë të rregullimit specifik ligjor. Ky opsion nuk adreson problematikat ekzistuese, si mungesa e standardeve të detyrueshme profesionale, e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe e përgjegjësisë profesionale. Për më tepër, nuk krijohen mundësitë për garantimin ushtrimit të profesionit me cilësi të shërbimeve dhe nuk mbështet në mënyrë efektive zhvillimin e bujqësisë si një nga profesionet kyce në këtë sektor.

Opsioni 1 – (rregullator) Ndryshimi i ligjit ekzistues për profesionet e rregulluara

Ky opsion parashikon ndërhyrjen në ligjin nr. 10171/2009, duke përfshirë edhe profesionin e agronomit në listën e profesioneve të rregulluara. Nëpërmjet miratimit të këtij ndryshimi, krijohet baza ligjore për përfshirjen e profesionit në kuadrin ekzistues rregullator dhe për aplikimin e rregullave të përgjithshme që lidhen me ushtrimin e profesioneve të rregulluara.

Ky opsion siguron zbatimin e disa risive:

- zgjerimin e fushës së zbatimit të ligjit ekzistues;
- vendosjen e kriterëve ligjorë për ushtrimin e profesionit të agronomit;
- krijimin e bazës për organizimin institucional dhe vetërregullimin përmes strukturave profesionale konkretisht Urdhri i Agronomit;
- forcimin e përgjegjësisë profesionale dhe mbrojtjen e interesit publik.

Ndërrhyrja ligjore është në përputhje me kuadrin ekzistues dhe njëkohësisht siguron krijimin e bazës ligjore për miratimin e ligjit të posacëm për rregullimin e profesionit të agronomit.

Opsioni 2 – (rregullator) Miratimi i një ligji të ri të posaçëm për profesionin e agronomit

Ky opsion do të konsistonte në hartimin dhe miratimin e një ligji të ri të dedikuar për rregullimin e profesionit të agronomit, përfshirë krijimin e një strukture të veçantë profesionale dhe përcaktimin e plotë të rregullave për ushtrimin e tij. Megjithatë ky opsion ofron një rregullim ligjor nuk është zgjedhja e duhur për ligjvënësin. Kjo sepse tashmë Qeveria ka një kuadër ligjor në fuqi i cili parashikon një sërë profesione të mbrojtura nga legjislatori. Parashikimi i një ligji të veçantë vetëm për miratimin e profesionit të agronomit nuk është zgjedhja e duhur për ligjvënësin në kuptim të rendit juridik në vend. Si e tillë nuk është opsioni i zgjedhur nga ana jonë.

Opsioni 3 – (jorregullator) Përmirësimi i praktikave administrative dhe rregullimeve sektoriale

Ky opsion konsiston në përmirësimin e praktikave ekzistuese nëpërmjet udhëzimeve administrative, trajnimeve dhe forcimit të monitorimit nga institucionet përgjegjëse. Ky opsion nuk krijon detyrime ligjore për profesionin e agronomit, nuk garanton vendosjen e standarteve për ushtrimin e këtij profesioni dhe nuk garanton parashikimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe përgjegjësisë profesionale. Për rrjedhojë, mbetet i pamjaftueshëm për adresimin e plotë të problematikave duke mos qënë opsioni i favorshëm për realizimin e qëllimit të ligjvënës.

Përfundimisht, Opsioni 1 është përzgjedhur si alternativa më e përshtatshme, pasi ndërhyrja në ligjin ekzistues për profesionet e rregulluara ofron një zgjidhje të menjëhershme, proporcionale dhe efektive, duke përfshirë profesionin e agronomit në kuadrin ligjor aktual dhe duke krijuar bazën për rregullimin e mëtejshëm institucional dhe profesional të tij.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Qëllimi që kërkohet të arrihet përmes miratimit të kësaj nisme ligjore konsiston në ndryshimet ligjore të projektligjit për profesionet e mbrojtura duke bërë pjesë të listës edhe profesionin e agronomit. Duke i miratuar ky ndryshim ligjor krijohet baza për miratimin e një ligji të ri të posaçëm për Urdhrin e Agronomit, i cili krijon ndikime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta mbi grupet kryesore të interesit.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë, nga miratimi i projektligjit të posaçëm, agronomët përfitojnë nga formalizimi i ushtrimit të profesionit përmes regjistrimit, rritjes së sigurisë juridike dhe forcimit të statusit profesional, ndërsa Qeveria përfiton nga përmirësimi i cilësisë së shërbimeve këshilluese dhe rritja e efektivitetit të politikave bujqësore nëpërmjet profesionalizimit të sektorit. Po ashtu në mënyrë të tërthortë, operatorët e sektorit bujqësor përfitojnë nga rritja e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve, përmirësimi i sigurisë ushqimore, ulja e humbjeve në prodhim dhe rritja e aksesit në tregje më të strukturuar. Institucionet arsimore dhe kërkimore përfitojnë nga nxitja për përditësimin e kurrikulave dhe forcimi i lidhjeve me praktikën profesionale, ndërsa konsumatorët përfitojnë nga produkte më cilësore, më të sigurta dhe nga një nivel më i lartë mbrojtjeje e interesit publik. Në tërësi, projektligji kontribuon në rritjen e standardeve profesionale, përmirësimin e funksionimit të sektorit bujqësor, si dhe në mbështetjen e praktikave më të qëndrueshme dhe konkurruese në ekonomi.

Të gjitha ndikimet e sipërcituara vijnë nga miratimi i ligjit të posaçëm “Për Urdhrin e Agronomit” ndërsa nga projektligji për ndryshimin e ligjit bazë për profesionet e rregulluara vetëm krijohet baza për miratimin e ligjit të posaçëm. Ky i fundit në vetvete nuk parashikon apo përmban efekte financiare apo ndikime të drejtpërdrejta ekonomike në asnjë nga grupet e sipërcituara.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Nga analiza shumëkriteriale e kryer për alternativat e mundshme rezulton se **Opsioni 2** ndërhyrja rregullatore nëpërmjet hartimit të projektligjit për ndryshimin e ligjit nr. 10171/2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” vlerësohet si opsioni më i favorshëm, duke marrë rezultatin më të lartë në raport me kriteret e vlerësimit të aplikuar. Për rrjedhojë, ky opsion propozohet si opsioni i preferuar.

Ky opsion paraqet zgjedhjen e duhur, të zbatueshme dhe në përputhje me kuadrin ekzistues ligjor, pasi mundëson përfshirjen e profesionit të agronomit në listën e profesioneve të rregulluara përmes një ndërhyrjeje të targetuar në legjislacionin në fuqi, duke shmangur mbivendosjet dhe fragmentimin normativ në hierarkinë juridike në vend.

Nëpërmjet këtij projektligji sigurohet përdorimi i mekanizmave dhe standardeve tashmë të konsoliduara për rregullimin e profesioneve, çka garanton koherencë në sistemin rregullator dhe rrit efikasitetin e zbatimit. Njëkohësisht, krijohet baza ligjore për:

- përcaktimin e kriterëve të ushtrimit të profesionit të agronomit;
- forcimin e përgjegjësisë profesionale;
- garantimin e mbrojtjes së interesit publik;
- organizimin e profesionit përmes strukturave të vetërregullimit, konkretisht Urdhri i Agronomit.

Ky projektligj nuk paraqet kosto financiare në buxhetin e shtetit apo edhe në sektorin privat.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominale)

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	0	0

KONSULTIMI PUBLIK

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer apo që planifikohet të kryhet (Metodat e ndjekura/që do të ndiqen; grupet e interesit që janë konsultuar/që do të konsultohen; rezultatet e pritshme/faktike të procesit?)

Projektligji iu nënshtrua procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, për një periudhë prej 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik. Publikimi u bë në datë **4.6.2026** dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJKP, ku të gjitha palët e interesuara:

- organet publike;
- shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;
- personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe
- personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Data e mbylljes së procesit të konsultimit ishte **2.7.2026**. Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 356 shikime në platformën online, por nuk janë regjistruar komente në RENJKP. Metodat e konsultimit

të përdorura për projektligjin “Për një shtesë në Ligjin Nr. 10 171, datë 22.10.2009, "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ishin:

-Konsultimi elektronik përmes Regjistrat Elektronik, RENJK (4.6.2026 – 2.7.2026);

-Marrja e mendimeve nga ministratë e linjës dhe institucionet e tjera, si proces i bashkrendimit të projektligjit nëpërmjet sistemit *e-akte* dhe komunikimeve elektronike.

Në përfundim procesi i konsultimit publik është kryer komform ligjit dhe nuk janë paraqitur komente nga palët e interesuara.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi i këtij ligji do të monitorohet nga strukturat përgjegjëse për profesionet e rregulluara, konkretisht Ministria e Arsimit, MA, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, MBZHR si dhe me strukturat e tjera të përfshira të shpëguara në vijim.

Në zbatim të Ligjit Nr. 10171/2009, MBZHR do të ketë rolin e institucionit përgjegjës për përcaktimin e politikave sektoriale dhe për mbikëqyrjen e ushtrimit të profesionit të agronomit, ndërsa MA do të jetë përgjegjëse për aspektet që lidhen me kualifikimin, programet e studimit dhe njohjen e diplomave që përbëjnë bazën për ushtrimin e profesionit.

Pavarësisht identifikimit të institucioneve të tjera të cilat marrin rol pas miratimit të ligjit të posaçëm për Urdhrin e Agronomit aktualisht ndryshimet ligjore në ligjin 10171/2009 sjellin efekte vetëm për Ministrinë e Arsimit, konkretisht:

Ministria e Arsimit kryen funksione monitorimi përmes:

1. Miratimit përputhshmërisë së programeve të studimit bazuar mbi kërkesat e profesioneve të rregulluara;
2. Verifikimet të kualifikimeve dhe diplomave të kandidatëve për ushtrimin e profesionit;
3. Bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë për sigurimin e standardeve të kualifikimit profesional.
4. Bashkëpunimi me institucione të tjera kërkimore me qëllim zbatimin e legjislacionit në fuqi për profesionin e agronomit.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0

MINISTËR
Andis Salla

